



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:001230

Datë: 13.08.2024

Numri i dokumentit: 06045008

P.nr.1/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çështjen penale ndaj të pandehurit V.B nga fsh....-Hani Elezit, i akuzuar për veprën penale, Vjedhja e shërbimve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1641/20 të datës 31.12.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.03.07.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Besnik Nuredini, përfaqësueses së të dëmtuarës T.K dhe të pandehurit, me dt.08.07.2024 mori dhe shpalli, ndërsa me dt. 07.08.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri V.B nga fsh....-Hani Elezit, i lindur më dt...., nga i ati K... dhe e ëma K..., e gjinisë M..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind I tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, I vetëpunësuar në restaurant "...i" në fsh....-Hani Elezit, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr.personal: ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse me dt. 21.03.2019 ora 14:28 min, në lokalin e tij në fshatin Pustenik-Hani Elezit, ka përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme energjinë elektrike për vete, në atë mënyrë që, pas ndërrimit të njehsorit nga ana e ...-it, me dt.29.06.2020, bazuar në leximet softwerike të Qendrës së Kalibrimit –...-SHA të dt.04.12.2020, është konstatuar se njehsori elektrik me nr. ...9 është ngacmuar me magnet, me të cilin veprim është penguar kalkulimi i shpenzimit të energjisë elektrike.

Me këtë veprim i pandehuri ka kryer veprën penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 2,7,38,48,69 dhe 70 të KPRK-se, si dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

GJYKON

Me dënim me kusht, me të cilin i vërtetohet dënimi me gjobë në shumë prej 500.00€ (pesëqind euro), i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej një viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk do të kryejë veprë tjetër penale, në të kundërtën do t'i revokohet dënimi me kusht.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë pranë kësaj gjykate shumën prej 50,00 € , ndërsa në emër të taksës për Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimit në shume prej 20.00€, të gjitha këto paguhen pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

E dëmtuaria ...-Distrikti në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.1641/20 të datës 31.12.2020, të pandehurin V.B nga fsh...-Hani Elezit, e ka akuzuar për veprën penale, 314 par.1 të KPRK-së.

Ne bazë të kësaj aktakuze gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt.11.11.2021, me të cilin rast i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Ne shqyrtimin gjyqësor të mbajtur në këtë çështje penale, prokurori i shtetit nga Prokuroria Themelore në Ferizaj, Besnik Nuredini, mbeti në tërësi pranë aktit akuzues të paraqitur me shkrim pranë kësaj gjykate. Në fjalën perfundimtare ka theksuar se, se pas administrimit të provave personale dhe materiale gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të tyre veq e veq dhe të gjitha së bashku, është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri V.B ka kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të kësaj aktakuze. Se i pandehuri ka kryer veprën penale me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, kjo u vërtetua më së miri me ndëgjimin e dëshmitarëve V. P.dhe E.B., punëtorë pranë Qendrës së Kalibrimit në Prishtinë, të cilët në konstatimin e tyre kanë vërtetuar se njehsori elektrik me të dhëna të paraqitura si në aktin akuzues, i regjistruar në emër të tani të pandehurit është ngacmuar me magnet ku ka penguar leximin e rregullt, me qka i njëjti njehsor nuk ka arritur të regjistrojë energjinë e shpenzuar, e për këtë më së miri flet prova materiale konkretisht mendimi dhe konstatimi i personave të autorizuar. Poashtu i pandehuri në mbrojtjen e tij nuk ka pranuar kryerjen e veprës penale duke e mohuar në tërësi me arsyetimin se gjatë asaj periudhe kohore lokali nuk ka punuar, ka qene i mbyllur si dhe gjatë asaj kohe ka qenë në shtetin e Turqisë për shërimin e vajzës së tij, e për këtë i njëjti ka prezantuar edhe pasaportën ,dhe është e vërtetë se ka qenë në shtetin e Turqisë, mirpo duke rënë në kundërshtim të plotë me prova të tjera që posedon Prokuroria, i njëjti në shqyrtimin e sotëm gjyqësor ka deklaruar se posa është kthyer nga shteti i Turqisë nga fundi i muajit Mars 2019 ka qenë tek restorani në fjalë duke u përgaditur për të filluar punën pasi që para gjykatës deklaroi se qysh në fillim të muajit Prill veq ka startuar me punë. E vepra penale me të cilën dyshohet se është kryer ka qenë pikërisht me dt. 21.03.2019 , çka do të thotë se i pandehuri gjatë mbrojtjes së tij vetëm ka dashur që t'i shmanget përgjegjësisë penale, mirëpo gjatë deklarimit të tij është vërtetuar e kundërta, e që do të thotë nga data e kryerjes së veprës penale i pandehuri ka qene prezent në Kosovë dhe atë tek biznesi në fjalë duke e përgaditur për të filluar me punën qysh në fillim të muajit Prill. Andaj mbi bazën e provave dhe dëshmive të ligjshme e të elaboruara më lartë ,kërkon nga gjykata që të pandehurin V.B, t'a gjej dhe t'a shpall fajtor për veprën penale e cila i ngarkohet dhe të njëjtit t'i shqiptojë një sanksion penal me të cilin në tërësi do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 38 i KPRK-së, ashtu që me

rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ndaj të pandehurit, të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, me qëllim që dënimi i shqiptuar të jetë në proporcion të plote me dashjen e kryerjes së veprës penale dhe veprime tjera të ndërmarra nga ana e të pandehurit . Përfaqësuesja e të dëmtuarës, T. K. në fjalën e saj I bashkangjitet në shqyrtimin gjyqësor I bashkangjitet ndjekjes penale dhe parashtron kërkesë pasurore juridike.

I pandehuri V.B, në fjalën e tij në shqyrtimin gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vehehet në barrë sipas aktit akuzues. Në mbrojtjen e tij ka theksuar se duke filluar nga data 15.03.2019 deri me e dt. 15.04 te vitit të njëjtë ka qenë në Turqi me vajzën për shërim dhe lokali ka qenë i mbyllur, prandaj nuk e sheh të arsyeshme që dëmi të llogaritet 12 muaj para sepse për çdo muaj ka qenë punëtori i ...-it për lexim të njehsorit dhe asnjëherë nuk ka patur vërejtje në njehsor, përkundrazi i kanë ardhur faturat për pagesë në bazë të atyre leximeve dhe pse duhet që t'I faturohet edhe një dëm tjetër në vlerën si në aktakuzë .

I njëjti pranon se ka qenë shfrytëzues i lokalit, për të cilin bëhet fjalë në aktakuzë, hapja e të cilit është bërë me dt. 01.05.2018 dhe ka qenë i hapur deri para 8 muaj, gjegjësisht Shtator – Tetor 2023, si dhe faktin se pas ndërrimit të njehsorit elektrik, pasi që ka vërejtur dëmin e evidentuar në faturë, ka ardhur në zyrën e ...-it në Kaçanik dhe me udhëzimin e tyre ka shkuar edhe në Ferizaj, por që këta të fundit nuk janë marrë me te, pastaj prapë është lajmëruar në zyrën e ...-it në Kaçanik për të kërkuar sqarim nga ana e tyre, se pse është kjo shumë, mirëpo nuk është njoftuar nga askush se dyshohet që njehsori elektrik i lokalit të tij është i ngacmuar me magnet dhe këtë e ka kuptuar vetëm kur ka ardhur në gjykatë. Në mbrojtjen e tij, I pandehuri ka theksuar se, ka qenë shfrytëzues I lokalit në fjalë që nga viti 2018, dhe para tij nuk e ka shfrytëzuar dikush tjetër lokalit dhe se vendosja e njehsorit elektrik është bërë prej zyrtarëve të ...-it në prezencën e tij, dhe arsyeja e dhënë nga zyrtarët e ...-it për ndërrimin e njehsorit ka qenë, sipas tyre, shpenzimet e vogla të energjisë në local-restaurant, dhe te njëjtën ditë kur është heq njehsori është bërë edhe regjistrimi i pajisjeve elektrike në lokal , dhe se të njëjtit kanë bërë disa here kontrole të njehsorit, duke u mundësuar qasje të lire në local, por nuk ka ndonjë document lidhur me këto kontrole, dhe nuk e ka ditur që duhet t'a kërkojë, derisa sipas tij njehsori ka qenë në rregull, nuk ka vërejtur diçka të pazakontë në njehsor. Lidhur me faturat e shpenzimeve të energjisë elektrike I njëjti ka theksuar se, ato kanë ardhur me rregull, dhe kane qenë prej 170-180 euro në sezon të verës deri 300 euro , ndërsa nga muaji mars vitit 2020, kur veq ka fillu pandemia, për shkak të masave kufizuese, në atë kohë nuk është punu në local. Për ndërhyrjet me magnet në njehsorin elektrik , I njëjti, pasi që prezenton edhe pasaportën e tij, kopja e të cilës I bashkangjitet shkresave të lëndës, ka theksuar se ka qenë në Turqi për shërim të vajzës prej dt. 04.03.2019 deri me dt. 19.03.2019, dhe shton se gjatë kësaj kohe lokali nuk ka punuar, por

qasje në local kanë patur vëllezërit e tij, meqë lokali ka qenë larg prej shtëpisë, prandaj ata janë përkujdesur, por që nuk ka njohuri që dikush t'a ketë prekur njehsorin elektrik, sepse në të kundërtën do të kishte treguar dhe nuk ishte marrë me këtë punë. I pandehuri, në mbrojtjen e tij, I pandehuri poashtu ka shtuar se pasi që është kthyer prej Turqisë, diku pas 10 dite ka filluar të punojë në local, pasi që e ka përgaditur lokalin për punë.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor prezantoi provat e propozuara me dëgjimin e dëshmitarëve: V. P. dhe E. B., leximin e procesverbalit me nr.2309045 i dt.29.06.2020, procesverbali mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik të dt.29.06.2020, fatura me nr.... e dt.30.06.2020 dhe Kalkulimi i RH , ID e rastit... e dt.30.06.2020.

Dëshmitari V. P. në dëshminë e tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale, deklaroi se, duke qenë udhëheqës I Qendrës së Kalibrimit ka marrë pjesë në leximet softverike të njehsorit në fjalë, dhe sqaron se njehsori në fjalë pasi është kontrolluar dhe testuar, duke mos patur të dhëna për konsumatorin përveq numrit unik, të gjeturat e konstatuara I shkarkojnë, dhe në rastin konkret njehsori ka qenë I ngacmuar me magnet. I njëjti më tutje ka sqaruar, se meqë kemi të bëjmë me njehsor smart apo të menqur, çdo ngacmim në memorjen e njehsorit regjistrohet, ku në këtë rast është vendosur magneti, prandaj edhe është konstatuar ngacmimi me magnet si vërejtje, dhe ky veprim normalisht që është I kundërligjshëm, derisa është I paautorizuar dhe nënkupton keqpërdorim, dhe se ngacmimi me magnet ka ndodhur me dt.21.03.2019. Dëshmitari më tutje ka sqaruar se në dokumenti I titulluar leximet softverike të datës 04.12.2020, përfshihen tarfiat me të lirë dhe me të shtrenjtë, lidhjet, tensioni amperazha, volltazha e njehsorit dhe në pjesën e fundit që quhet Event janë konstatuar ngacmimet dhe vërejtjet me datë dhe me kohë, dhe shpjegon se dokumenti leximet softverike të njehsorit vetëm në pjesën e eventit tregon mënyrën e keqpërdorimit dhe kohën kur janë bërë ato, konkretisht me dt.21.03.2019 prej orës 14:28 min deri me 14:29 min. Dëshmitari, në fjalën e tij, poashtu ka theksuar se me rastin e leximeve softverike, zyrtarë e departamentit të metrologjisë nuk marrin përgjegjësi, ndërsa për raste të dëmtimve brendshme të njehsorit apo pllombat, I njoftojnë ata.

Dëshmitari E. B. në dëshminë e tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, deklaroi se duke qenë se punon në Qendrën e Kalibrimit në pozitën teknik në kalibrim, ka marrë pjesë në komisionin përkatës, ka bërë leximin e njehsorit m numër ... dhe e mbështet konstatimin në këtë document. I njëjti më tutje sqaron se te njehsori në fjalë janë bërë katër lloje të leximeve, ku në këto lexime softverike kanë hasur në komentet apo error Magnetic field detection Start-Stop, ku ky koment apo error kod, si e quan dëshmitari, tregon ngacmimin e një fushe magnetike nga ana e jashtme

njehsorit, e cila ka për qëllim pengimin e regjistrimit të energjisë elektrike të shpenzuar, dhe nga dokumenti në fjalë shihet qaratazi se është bërë ndëryrje duke treguar fillimin dhe mbarimin, dhe për pasojë është bërë pengimi I kalkulimit të energjisë elektrike të njehsori në fjalë me anë të një fushe magnetike ashtu siq edhe njehsori e ka detektuar. E duke patur parasysh se njehsori është i prodhuar asioji që të bëjë numërimin dhe të kalkulojë shpenzimin e energjisë elektrike, çdo ngacmin që pengon në këtë kalkulim logjikisht dhe ligjërisht është e pa ligjshëm.

Nga dëshmia e këtyre dëshmitarëve Gjykata ka konstatuar se në njehsorin elektrik me nr.69077289, me dt. 21.03.2019 ka patur ndërhyrje, apo siq e quajnë dëshmitarët ngacmim me magnet, dhe për pasojë është penguar regjistrimi dhe kalkulimi I energjisë elektrike. Gjykata u fali besimin këtyre dëshmimeve, meqë dëshmia e tyre mbështetet edhe në dokumentin, Leximet software-ike të njehsorit me nr.237 të dt.04.12.2020.

Nga procesverbali me nr.2309045 të dt.29.06.2020 dhe procesverbali mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik të dt.29.06.2020, gjykata ka vërtetuar se tek lokali-restauranti I të pandehurit me adresë në fsh....-Hani Elezit, në presence të të pandehurit, është bërë regjistrimi I pajisjeve elektrike dhe ndërrimi I njehsorit elektrik, I cili pasi që vendoset në një qese të posaqme dhe pllombohet, dërgohet në Qendrën e kalibrimit në Prishtinë.

Pas prezantimit të këtyre provave të lartëcekura dhe vlerësimit të tyre te plotë, secilën veç e veç dhe të gjitha në tërësi, mbrojtjes se të pandehurit si dhe bindjes së lirë te gjykatës, gjykata vërtetoi gjendjen faktike si ne dispozitiv.

Gjykata u dha besimin provave të prezantuara sepse me të njëjtat ne mënyrë të qartë dhe bindëse është përshkruar koha ,vendi dhe mënyra e kryerjes së veprës penale.

Gjykata vlerësoi posaçërisht edhe mbrojtjen e të pandehurit, përmes së cilës i pandehuri e ka mohuar fajësinë për veprën penale, duke u arsyetuar se nuk e ka bërë ndërhyrjen apo ngacmimin me magnet meqë I njejt nga data 04.03.2019 deri me dt. 19.03.2019, ka qenë në Turqi për shërim për vajzën e tij, dhe se deri 10 ditë pasi është kthyer nga Turqia nuk ka filluar punën në local. Mbrojtjes së të pandehurit se I njejt ka qenë në Turqi prej dt.04.03.2019 deri me dt.19.03.2019, Gjykata I fali besimin meqë kjo vërtetohet edhe me pasaportën e tij të prezentuar para gjykatës, mirëpo duke patur parasysh se I njejt është kthyer nga Turqia me dt.19.03.2019 ndërsa ndërhyrja në njehsor ka ndodhur me dt. 21.03.2019 pra në kohën kur I pandehuri ka qenë në Kosovë, dhe ate, bazuar në deklarinimin e tij se pasi është kthyer nga Turqia, dhjetë ditët e para, e

ka përgaditur lokalin për punë, vërtetohet se I njëjti në kohën për të cilën bëhet fjalë ka qenë duke e përgaditur lokalin për të filluar punën. Kjo edhe për faktin se, nga vetë deklarimi I të pandehurit, Gjykata vërteton se, lokalin në fjalë nuk e ka shfrytëzuar dikush tjetër, përveq të pandehurit, derisa vëllezërit e tij janë kujdesur për lokalin vetëm derisa I pandehuri ka qenë në Turqi.

Poashtu gjykata vlerësoi edhe provat materiale si: Fatura ... dhe Kalkulimi I RH-së, të dyja të dt.30.06.2020, mirëpo duke patur parasysh faktin se , bazuar në deklaratimet e dëshmitarëve por edhe në dokumentin Leximet software-ike të njehsorit, si kohë e ndërhyrjes në njehsor është konstatuar vetëm data 21.03.2019 prej orës 14:28 :15 min deri – në 14:29:45, është kohë shumë e shkurtër e ndërhyrjes për t'u shkaktuar dëmi në vlerë prej 1,020.21 €, derisa dëmi në vlerën si më lartë është llogaritur për 12 muaj, para dates 29.06.2020, bazuar në dokumentet e lartëcekura, por edhe në sqarimin e përfaqësuesit të të dëmtuarës, prandaj edhe këtyre provave materiale, në këtë çështje penale, Gjykata nuk u fali besimin, derisa si e dëmtuar ...-Distrikti në Ferizaj, për këtë çështje është udhëzuar në contest të rregullt juridiko-civil.

Nisur nga këto fakte të vërtetuara ne procedurë, gjykata vërtetoi se ne veprimet e të pandehurit, manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Vjedhja e shërbimve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata gjeti faktin se, bazuar në evidencën e gjykatës i njëjti nuk ka patur ndonjë rast tjetër penal të kësaj natyre apo tjetër , ndërsa rrethanë të posaqme rënduese për të pandehurin gjykata nuk gjeti, përveq veprimeve të të pandehurit të cilat paraqesin elemente të veprës penale, për të cilë është shpallur fajtor.

Andaj, gjykata për këto arsye, të pandehurin V.B i akuzuar për veprën penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të

mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë tek i pandehuri dhe personat tjerë që të shmangen nga kryerja e veprave penale, dhe të forcojë detyrimin për respektimin e ligjit, dhe me këtë edhe të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhezimin e të demtuarës në contest civil për realizimin e demit, u mor konform nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr. 1/21 datë 07.08.2024

Sekretarja Juridike
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.